

ASIME FERAJ

ONOMASTIKA NË KRIJIMTARINË E FATOS ARAPIT

Nëpërmjet emërtimeve onomastika fikson forma dhe dukuri gjuhësore që mund të vlejnjë si dëshmi të vyera për të ndriçuar udhën e përshkruar nga bartësit e atyre emrave në shekuj, duke sjellë përpara të dhëna të besueshme e për periudha të murgëta, ndonjëherë edhe të lashta e për të cilat nuk ka pasur asgjë të shkruar. Nga kjo pikëpamje onomastika, për raste si ai i Shqipërisë dhe i trojeve shqiptare, në mungesë të dokumenteve të shkruara, onomastika mbetet si “arkivi gojor” i historisë dhe i lashtësisë së kulturës sonë në hapësirën ballkanike. Nuk ka qenë e rastit që, qysh në agimet e shkencës albanologjike, ndër më të parat hulumtime rreth lashtësisë së shqiptarëve e gjuhës shqipe, si gjuhë e njërit prej popujve më të vjetër të Ballkanit, studiuesit i janë drejtuar me përkushtim dhe zell pikërisht onomastikës së trojeve ku kanë qenë ilirët e ku kanë vijuar të jenë më sot shqiptarët. Materialin onomastik të parët e kanë futur në përdorim rilindasit shqiptarë, nga njëra anë, për të dëshmuar origjinën e lashtë të shqiptarëve dhe, nga ana tjetër për qëllime poetike; studiues të huaj e dashamirës të shqipes e të shqiptarëve për të provuar origjinën ilire të shqipes e të shqiptarëve.

Toponimet dhe antroponimet janë emra të përveçëm dhe, si të tillë, kanë të përbashkët burimin e tyre kryesisht nga emra të përgjithshëm (apelativa). Kjo dukuri është universale për të gjitha gjuhët e botës, pëllumb – **Pëllumb** dëshirën që djali të bëhet si pëllumb, **Pëllumbari** fshat në Përmet; nga emri **zog/u** janë formuar antroponimet **Zoga**, fjala zog ka shërbyer si toporrënjë edhe për **Zogaj**¹.

F. Arapi është njohës i traditës së onomastikës dhe ecën edhe vetë në këtë rrugë, duke na dhënë antroponime dhe toponime nga e njëjta rrënjë **pëllumb**: Dane *Pëllumbi*, në shtëpinë e *Pëllumbajve* “**Shokët**”, oronimin *Qafa e Pëllumbit* “**Poezi**”, mikrotoponimin *Pylli i Pëllumbave* “**Deti në mes**”, oikonimin *Pëllumbas*, etnonimin *Pëllumbasit*, “**Shokët**”.

Janë me rëndësi të madhe makrotoponimet apo emrat e “pikave kyçe”, siç kanë qenë në shekuj malet e pikëkalimet më të dukshme, krahinat dhe qendrat e mëdha të banuara, por nuk janë për t’u përjashtuar as mikrotoponimet, sepse ato, sidoqoftë, edhe pse mund të jenë më të reja e me plot shndërrime të përfutuara vonë, mund të na japin siguri rreth traditës dhe mjeteve e mënyrave karakteristike që kanë qenë tradicionale në vënien e emrave të vendeve e të njerëzve nga të parët tanë².

¹ Gjovalin Shkurtaj, *Onomastikë dhe linguistikë*, shblu, f. 13-43, Tiranë, 2001.

²Po aty, f. 44-45.

Onomastika në përgjithësi e toponimia në veçanti me fjalët format dhe elementet e ndryshme leksikofjalëformuese që ngërthen në to përbëjnë një lëndë të vlefshme e që mund të plotësojnë në një masë të mirë mungesën e dokumenteve të shkruara, duke marrë kështu një vlerë të rëndësishme dërrmuese.

Në këtë vështrim, onomastika duhet parë si një histori e pashkruar e popullit, dëshmitë e së cilës për nga rëndësia vihen krahas me gjetjet arkeologjike.

F. Arapi njih mirë rëndësinë e onomastikës, ai është i vetëdijshëm për funksionin emërtues të antroponimeve dhe toponimeve si dhe funksionin stilistikor të tyre. Kjo duket në numrin e shumtë të tyre, rreth 700 të tilla, në veprat e studiuara prej nesh. Fjalët e veçanta takohen si në poezi edhe në prozë, si në veprat e shkruara më herët edhe të atyre shkruar më vonë. Por për lëndë të pasur onomastike do të veçonim përmbledhjen me vëllime poetike “Poezi”, poezi të zgjedhura “Eklipsi i ëndrrës”, romanet “Deti në mes”, “Shokët”, si dhe përmbledhja me novela “Nuk shitet shpirti në tetor” një vepër në të cilën kujdesi dhe pjekuria e autorit për onomastikën vërehet me lehtësi dhe shijohet në një mënyrë të veçantë.

Për rëndësinë e veçantë që tregon autori për lëndën onomastike flasin edhe titujt e poezive: *Drashovica, Në Llogora, Në Zvërnec, U krodha në ujrat e Jonit, Baladë për Muço Matohitin, Shqipëria, Në .., Teli Ndini, Shyqyri Alimerko, Lefter Sallata, Pirro Palla, Fiqiri Muka, Jani Mone, Fadil Dauti, Hysen Çino, Dadan Dajlani, Vlora e fëmijërisë, Skënderbeu, Vrana Konti, Lekë Dukagjini, Sulltan Murati, Albulena “Poezi”; Fyelli i Tomorrit, Qielli i Tiranës gjithë lluc, Përshpirtje për Vllasin, Kam harruar Fatosin, Akreonti rrjedh po Karont nuk ka, Herë-herë Penelopës, Vrasja e Pentësilesë, Ra zemrë e Narcizit në tokë, Kjo ndodhte në Madrid, Dhe je Evropë, Në stacionin Sen-Zhan de Murien, Duke u nisur për Zyrih, Te Ura Mirabo, Në Berlin, Dahau, Anës Vjosës, Ka diçka prej qiellit të Parisit, Pirrua, Fushë-Kosovë, Lekë Dukagjini, Albulena, Kaçaniku, Rugovasi, Vajza e vogël me emrin Vlora, Kosovë 1999, Homeri ishte i verbër “Eklipsi i ëndrrës”*. Është vetë jeta e autorit, miqtë e fëmijërisë, është vendlindja, vendet në të cilat ka shkelur, apo ka vendosur ngjarjet.

Emrat vetjakë të zakonshëm, të traditës, të marrë nga historia, nga mitologjia dhe ata të krijuar nga vetë autori, nuk kanë funksion të jashtëm gjuhësor-historik, por funksion sendërtues të veprës në përgjithësi dhe atë tipizues në veçanti. Emrat e përveçëm, emrat e personazheve dhe të vendeve të përdorur në veprën e tij janë të kushtëzuar nga tematika dhe areali mbi të cilin zhvillohen ngjarjet dhe personazhet.

Onomastika letrare ashtu si dhe vetë gjuha në krijimtarinë e F. Arapit nuk është studiuar. Pasuria onomastike e vërejtur te F. Arapi do të ndihmonte edhe studimet gjuhësore-historike. Krahas emërtimit të vendeve e njerëzve ajo sjell edhe informacion të bollshëm për emrat e veçantë shqip e në veçanti të krahinës së Labërisë, një areal sa i ngjashëm aq edhe i veçantë me trevat e tjera shqiptare.

Antroponimet

Kemi trajtuar lëndën onomastike edhe nga ana etiologjike edhe nga ana etimologjike (aq sa mundëm), duke pasur si mbështetje tekstin “Onomastika” të prof. Gjovalin Shkurtaç, botime të autorëve të mirënjohur në këtë fushë si Shefkije Islamaj, njohurive vetjake, pasi dhe vetë i përkas kësaj krahine, si dhe konsultimeve me profesorë e persona të tjerë, njohës të mirë të kësaj treve.

Shtresat e antroponimisë

Ky fond përbehet nga dy grupe të mëdha: Emra me burim vendas dhe të huaj.

a. Emra me burim vendës. Të bie në sy parapëlqim i autorit për emra të tillë. Emrat më të pëlqyer dhe të përdorur prej tij janë (fjalë të fondit të vjetër të shqipës) si: *dritë, gur, mirë, bardhë (i)*, përdorur edhe si emër i përveçëm edhe si emër familjar, apo edhe më tej si toporrënjë, si në antroponimet me burim popullor ashtu edhe të krijuara nga autori: *Bardha Kuca, Bardhaj, Gurëbardhë; Drit Bora, Boras; Met Guri, Ilir Guralumit, Gurëbardhë; Mira Vogli, Suzana Miroshi, kritiku Bukëmira ... etj.*

Shqip: *Greth, Ilir, Besnik, Engjëll, Drit, Bardha, Agim, Azem, Redon, Afërditë, Korab, Mira, Shega, Zamir, Kopil, Hiçi, Hiçkëla, Bato, Agimi, Azem, Bardhyl, Labike, Lelo, Vojo, Prënjo, Lekë, Ilir, Kilje, Refik, Lame, Lara, Agim, Rrufe, Kume, Gjena, Kujtim, Teno, Dodona, Hamza, Pirro, Milo, Leksi, Mërkur, Ago; Patronime:* *Gjonomadhi, Shkurraj, Bunga, Duka, Bardhaj, Balli, Guralumit, Bisha, Bora, Ulku, Bruka, Tokaj, Gruda, Vogli, Miroshi, Arëza, Milori, Shtërgu, i Madh, Bukëmira, Çobani, Hajdutit, Keqi, Kaleshi, Ulku, Bubesi, Bisha, Kuca, Duka, Guri, Fejzo, Zeqo, Sallata, Palla, Pëllumbaj, Cukalla, Zeqo, Lapi, Gjomema, Kelmendi, Baboçi, Guri, Dukagjini, Zaharia, Dajlani, Duka, Molla, Aliu, Bejko, Çerma, Deloja, Brahime, Dauti, Garunja, Alimerko, Vllahu, Myrto, Buxhuku, Bodinas, Niku, Ndreu, Dukagjini, Tutulani, Ndini, Matohiti, Muka, Mone, Dauti, Lelo, Golemi, Kastrioti, Konti, Frashëri, Podrimja.*

b. Emrat e përveçëm të huaj

Jo të pakta janë edhe antroponimet me origjinë **turke e arabe:** *Abaz, Ali, Esma, Evrenoz, Fadilit, Fiço, Hatixhe, Hyso, Muharrem, Zeqo, Myrto, Xhavit, Xhezo, Qemal, Shyqo, Shyqyriu, Osman Skënder, Bajram, Nesho, Fato, Halo, Myrto, Mevlud, Vezir, Alush, Hazhi, Yzeir, Mehmet, Ahmetit, Faraoni Madh, Niko, Xhelo, Ndre, David, Isuf, Moisi, Gjikë ...etj.*

Gjithashtu një vend të rëndësishëm zënë **antroponimet greke:** *Sokrat, Andon, Lefter, Filip, Vangjel, Kristo, Niko, Andre, Nastë, Dhoksi, Nasi, Lena, Pavli, Jani, Homeri, Promete ... etj.*

Antroponimet **latine** ndeshen kryesisht në krijimet me temë nga e kaluara historike. Në të gjitha rastet emra të tillë janë të personazheve të huaj, përveç *Mio Balli*, dhe *Vita* personazhe shqiptarë. Emra latinë janë: *Mikele, Musolini, Viktor, Vita, Mio, Putana, Suzana, Çezare, Bruti, Duçe, Xhino, Roveli,*

Agostini, Maurini Karlo, Pietro, Luixhi, Xhankarlo, Ugo, Xhirolamo, Roko, Karlo, Otello, Desdemona.

Antroponimet **angleze e gjermane** dalin më pak ndër antroponimet e huaja: *Adolf, hoxha Bite, Ana, Hamlet, Valter, Alfons, Rusvelt Churchill.*

Antroponime nga **slavishtja** dalin fare pak. Ato janë: *Çerma, Natasha.*

Vendin kryesor ndër emrat e përveçëm e zënë ato me origjinë shqipe. Kjo ide përforcohet nëse shohim edhe frekuencën e përdorimit të tyre. Emrat me origjinë ilire dhe shqipe janë dhe fjalët onomastike me frekuencë më të lartë: Azem (330x), Labike (129x), Bardhyli (117x), Agimi (73x), Bato (72x), Rrufeja (6x), Leloja (4x), *Refiku* (4x), Leka (3x), Kume (2x), emërtimet e tjera përdoren vetëm nga një herë. Antroponimet e huaja dalin me denduri më të vogël: Gjikä (112x), Skënderi (35x), Xhavit (24x), Nesho (20), Esma (16x), Aliu (10x), Evrenozi (8x), Muharrem (6x), Fatoja (5x), Fiqo (4x), Fadilit (3x), Hyso (3x), Halo (2x), Mevlud (2x), Zeqoja (2x), etj. të cilat përdoren vetëm nga një herë.

Një shtresë përbëjnë edhe **emrat e vjetruar me origjinë nga turqishtja.**

Me një vështrim të lehtë vihet re edhe rasti: antroponimi fjalë e huaj, sidomos me burim turk, dhe patronimi shqip. Kjo shpjegohet me kontekstin historik; në bashkëjetesën e gjatë me pushtuesin shqiptarët me dëshirë apo pa dëshirë morën prej tyre edhe emra vetjakë, por patronimi si më i vjetër dhe më domethënës vazhdoi të jetojë i paprekur. Kemi emrat: *Ali Molla, Dane Pëllumbi, Alem Bejkos, Ali Kelmendit, Hysen Kalesshi, Met Guri, Isuf Lika, Esma Dardani*; Antroponimi dhe patronimi fjalë e huaj dalin fare pak: *Halo Myrtoja, Vezir Alushi, Osman Aliu.*

Emra të tillë i shërbejnë paraqitjes me vërtetësi, por edhe më me larmi e në përputhje me mjedisin që kapin ngjarjet. Ato janë sjellë me masë, pa e tepruar dhe pa e rënduar tepër mjedisin, por si një mjet i dobishëm i mishërimit artistik të veprës letrare.

Gjatë studimit të hollësishëm të emrave vetjakë kemi dalluar edhe shtresa të tjera. Një shtresë e rëndësishme është ajo e **emrave popullorë**. Te Fatos Arapi gjejmë vazhdimin e së njëjtës prirje, emrat e përveçëm të njerëzve, antroponime që vijnë nga emra të përgjithshëm si: *Agimi* nga mëngjes herët (në agim), *Lara* nga lopë (me lara), *Rrufeja* nga rrufe, *Kume* nga kumë (rërë), *Luan* nga luan, *Refiku* nga fik, *Shega* nga shegë, *Dritë* nga drit, si dhe **patronimet**: *Gjena Bletaj* nga bletë, *Ali Molla* nga mollë, *Dane Pëllumbi* nga pëllumb, *Alem Bejkos* nga bejkë (dele), *Teno Çobanit* nga çoban (bari), *Drit* dhe *Skënder Bora* nga borë, *Zamir Milori nga milor (qengj mashkull)*, *Ago Arëza* nga arë, *Pirro Palla* nga pallë, *Lefter Sallata* nga sallatë, *Velo Shtërgu* nga shtërg ... etj.

Kjo është shtresa më e pasur e cila nuk ka reshtur asnjëherë, madje vazhdon të pasurohet nga gurra e emrave të përgjithshëm. Autori ndërton sipas këtyre gjedheve patronimet: Afërditë *Tokaj* nga tokë, *Bukëmira* nga bukë etj.

Një pjesë e emrave dhe mbiemrave janë përdorur **në origjinal** si: *Qeriba Derri, Margarita Tutulani, Teli Ndini, Lef Sallata, Fiqiri Muka, Shyqyri Alimerko, Dadan Dajlani, Muço Matohiti, Gogo Mati...* etj. Këto janë figura të njohura të historisë të krahinës së Labërisë, por edhe më tej. Autori tregon mirënjohje dhe respekt për ta dhe kontributin e tyre në mbrojtjen e atdheut.

Tek emrat e veçantë mund të veçonim edhe shtresën **me burim fetar**, të krishterë ose myslimanë, si pasojë e ndikimeve të feve të ndryshme.: *i biri i Kristo Gurit, atë Nikodhimi, atë Vasili*, batalionin e *Baba Fejzos*, Ndre *Davidit, Gjikë Duka, Osman Aliu, Ali Molla, Alem Bejkos, Gjonmadhi, Gjikë Duka, Marien e Gjokajve, Gjena e Bletajve, Thoma, Miti, Natasha e xha Mehmetit*.

Një shtresë është ajo ku **emrat e veçantë kanë një domethënie**. Kështu kemi: *Marien e Gjokajve, Gjena e Bletajve, “Deti në mes”*; *Kristo Driza, Niko Gropa, Met Guri, Ago Arëza, Bardha Kucaj, kritiku Bukëmira, Guralumi*.

Me burim mitik: *Abeli, Kaini, Zeusi, Efesti, Pandora, Itaka, Troja, Çirçe, Pentesilenë, Qentë mollosë, Pegasëve, tiranë, Persefonë, Orfe, Dahau, Apollon, Afërditë, Venera, Dodona, Akrokerounet, Karont “Eklipsi iëndrrës” Qikllopi, Ulisi “Shokët” Hektori, Priami, Dardan, In-tenebris Akili, Teti “Duke dalë prej ëndrrës”*.

Një shtresë emrash të përveçëm **figura të njohura të historisë së largët:** *Pirro, Bardhyl, Akili, Lekë Dukagjini, Skënderbeu, ...* etj. Karakteristikë është sjellja e tyre në kohë. Autori është bashkëkohës, bashkëbisedues, bashkëvuajtës me ta: *Do të kapërcejmë Jonin mbreti im. / Fatin tonë perënditë e egra kërkojnë fli të reja*.

Ka shumë dhimbje, lot e trishtim me këto emra. Është vetë fati tragjik i atdheut. Një pjesë të tyre autori i thërret për ndihmë për ta nxjerrë nga eklipsi.

Ndërtimi i antroponimeve

Emrat e familjeve, siç thotë prof. Rami Memushaj, përbëjnë një nga thesaret më të qëndrueshme të thesarit onomastik, pasi nuk lidhen me individë të veçantë, që rrojnë jo më shumë se tre breza, por me grupe individësh të shumë brezave, ato ruhen më gjatë në gjuhë, duke ndryshuar vetëm për arsye të forta³.

Një vajtje – ardhje të pandërprerë ka edhe kalimi nga emrat vetjakë (**antroponimet**) tek emrat familjarë (**patronimet**). Së pari duhet të përmendim rrethanën që në traditën e hershme shqiptare (ashtu si edhe në mënyrë universale) emri vetjak i atit ka shërbyer si emër familjar: *Xhelo Lapi, Niko Leli, Ndre Davidi, Jani Leli, Lefter Pavli, Teno Çobani, Milo Ndreu, “Deti në mes”*; *Met Guri, Fadil Dauti, Dadan Dajlani nga “Poezi”*;

³Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe* (përmbledhje artikujsh), f. 288, Botart, Tiranë, 2011.

Sipas prof. Gj. Shkurtajt, në krye të herës patronimi ishte në rasën gjinore. Kjo vërehet edhe tek autori ynë. Kemi ndërtime si: *Marien e Gjokajve, Gjena e Bletajve, Pandi i Dakajve, “Deti në mes”*. Më vonë patronimet u përdorën në rasën emërore. F. Arapi sjell mjaft raste me ndërtime të tilla si: *Kujtim Garunja, Lame Zeqoja, “Shokët” Xhelo Lapi, Niko Leli, Ndre Davidi, Jani Leli, Lefter Pavli, Teno Çobani, Milo Ndreu, Dimo Vllahu, “Deti në mes”; Shyqyri Alimerko, Fejzo Gjomema, nga “Poezi”*.

Ndeshim edhe trajtën trigjymtyrëshe si (Gjergj Elez Alia): *Hasani i Met Aliut, Kara-Meleq-Dereber-pasha i biri i Ngjelit të Niko Gropës “Deti në mes”*.

Kemi dy raste, një më i vjetër, vjen qysh nga mesjeta “*Unë, robi i perëndisë, atë Vasili, i biri i Ngjelit të Niko Gropës, po hedh këto fjalë në radhua, që t’i dini ju që vini pas nesh*”. Dhe një më i vonë:

- Hasan. Hasani i Met Aliut jam.

- *E gëzofsh! A ka shumë gjermanë në fshat?*

Kemi pak ndërtime të tilla, sa për të treguar se trajta të tilla kanë qenë të zakonshme dhe gjallojnë ende.

Ndeshim një tjetër veçori të antroponimisë:

Të njëjtët emra të përveçëm mashkullorë, kur shërbejnë si patronime për meshkujt dhe janë në bashkë vajtje emri i birit është në trajtë të pashquar, kurse emri i atit patronimi del në trajtën e shquar: *Kristo Driza, Niko Gropa, Kristo Guri, Ndre Davidi “Deti në mes”; Lekë Dukagjini, Met Guri, Fadil Dauti, Pirro Palla, Lefter Sallata, Dadan Dajlani nga “Poezi”; Kujtim Garunja, Lame Zeqoja romani “Shokët”*.

Me mbaresën **-a**: *Skënder Bora, Azem Bunga, Gjokë Duka, Ali Molla, Isuf Lika, Kujtim Garunja, Lame Zeqoja, Mërkur Deloja, Halo Myrtoja, Pirro Palla, Lefter Sallata, Kristo Driza, Niko Gropa, Fejzo Gjomema*.

-i: *Xhelo Lapi, Niko Leli, Ndre Davidi, Jani Leli, Lefter Pavli, Teno Çobani, Fiço Hajduti, Duk Keqi, Hysen Kaleshi, Miroshi, Balli, Bubesi, Kelmendi, Dukagjini, Dajlani, Dauti, Golemi, Kastrioti, Konti, Frashëri, Tutulani, Ndini, Matohiti, Guralumi, Vogli, Brahim, Milori, Guri, Gjonomadhi*.

-u: *Milo Ndreu, Dimo Vllahu, Met Aliu, Sazan Ulku, Agim Buxhuku, Nik Niku*

-o: *Alimerko, Myrto, Lelo*

-aj: *Tokaj, Pëllumbaj*

Më tepër dalin patronimet me formë përfundimtare në emërore me prapashtesën **-i**, më pas me prapashtesën **-a** dhe më pak me **-u**. Në trajtën e pashquar dalin me mbaresën **-o** në njëjës dhe me **-aj** në shumës. Këto raste janë më të rralla.

Emrat familjarë të vendlindjes: Ilir *Guralumi, Korab, Gruda “Nuk shitet shpirti në tetor”*; Dane *Pëllumbi “Shokët”*, si dhe rastet e njohura *Frashëri, Dukagjini, Golemi* etj.

Mbiemra vetjakë që bartin kuptime **me konotacione pozitive apo negative**. Antroponimet dhe patronimet e shëmtuara⁴ Duk *Keqi*, Xhavit *Çermën*, Fiqo *Hajdutit*, Hysen *Kaleshin* (Hysa Kaleshin), romani “**Shokët**” *Putana* e Madhe *Kopili* i Madh, *Faraoni* Madh, *Hiçin* e Madh, zonjës *Hiçkëla*, *Greth* Bubesi, Besnik *Bisha*, *Bardha* Kuca, Sazan *Ulku*, “**Nuk shitet shpirti në tetor**”; Suzana *Miroshi*, Redon *Bruka*, Ilir *Guralumit*, Afërditë Tokaj, Korab Gruda, shkrimtarit *Engjëll* Cukalla, kritikun letrar *Bukëmira*, *Drit Bora*, Sazan *Ulku*, Agim *Buxhuku*, “**Nuk shitet shpirti në tetor**” Agimi, *Rrufeja*, *Skënder Bora*, Ali Molla, “**Shokët**”; *Xhelo Lapi*, *Kristo Gurit*, Gjena e Bletajve, “*Deti në mes*” *Dritë*, “**Patat e egra**”

Emra etnik të banorit (a banores), të cilët zakonisht vijnë prej emrave të ojkonimeve shqiptare, formohen me anën e prapashtesave:

-it: *Bodinasit*, *Pëllumbasit*, në shtëpinë e *Pëllumbajve* (romani **Shokët**)

-aj: Bardhajt, në shtëpinë e *Pëllumbajve*, romani **Shokët**; fisi i *Bodinakajve*, “**Dhjetori i shqetësuar**”

Ose vetëm me shtesë të një **i-je** para emrit të vendit: *për fisin tonë të Brahime* (i Brahime), karakteristikë për krahinën e Labërisë.

Toponime

Emërvendet⁵ e përdorur nga autori janë të shumta në numër dhe shumëllojshmëri. Ajo nis me *shushurimën e lisit të Dodonës*, me *lavdinë tragjike të Epirit*, me *klithjen thesprote*, me *buzëqeshjen mollose*, e *gjakun e Arbërit*, me *Aulonën e zhdukur*, me *fushën e luftës në Albulenë* (**Eklipsi i ëndrrës**), vijon me *Vlorën*, *Sazanin*, *Kosovën*, *Tiranën*, me male, fusha, fshatra, pyje e ara. Kjo ndihmon në lokalizimin e ngjarjeve, i jep veprës vërtetësi dhe besueshmëri, por kryen edhe funksion stilistik. Ajo sjell edhe një pasuri të madhe leksikore e gjuhësore, si në kuptim ashtu edhe me ndërtimin e tyre.

Emrat e përdorur më tepër janë:

Në emrat e vendeve të krahinave të mëdha e të vogla, të qyteteve e qytezave madje edhe në emrat e katundeve e lagjeve të gjitha pa përjashtim paraqesin tiparin karakteristik themelor të shqipes: shquarsinë dhe pashquarsinë.

Kemi emërvende që përdoren në trajtën e pashquar: *Sherishtë*, *Lapardha*, *Bashtë*, *Hormovë*, *Lekël*, *Topovë*, *Vlorë*, *Delvinë*, *Gurëbardhë*, *Rrëzë*, *Drashovicë*, *Durrës*, *Tunemisht*, *Albulenë*, *Brataj*, *Kaninë*, *Penkovë*, *Dukat*, *Shkozë*, *Kalivaç*, *Dorëz ... etj.*, si dhe emërvende që përdoren në trajtën e shquar: *Aulona*, *Kruja*, *Borasi*, *Bërrylas*, *Repishti*, *Kota*, *Berati*, *Orikumi*, *Lubonja* e *Penkova ... etj.*, por ajo që e ilustron më tepër idenë janë përdorimet e së njëjtit emërvend në të dy trajtat njëkohësisht: *Vlorë – Vlora*, *Labovë-*

⁴Gjovalin Shkurtaj, *Onomastikë dhe linguistikë*, shblu, f. 155, Tiranë, 2001.

⁵ Sh. Islamaj, *Gjergj Fishta Gjuha dhe stili*, f. 478, Prishtinë, 2012.

Labova, Lekël- Lekzi, Rrëzë- Rrëzoma Drashovicë-Drashovicë, Penkovë-Penkova, Boras- Borasi ... etj.

Karakteristikë tjetër e emërvendeve është se disa prej tyre vijnë nga emra njerëzish plus prapashtesa të ndryshme të shqipes, ku shquajnë sidomos **-aj / -anj**: në *Sinanaj, Matohasanaj, fshatin e Vajzës, në Lllazat*.

Emrat e vendeve (**toponimet**), duke qenë kaq të shumta dhe të ndryshme, i kemi grupuar edhe sipas ndarjeve të tjera në: **ojkonime** apo emrat e vendeve të banuara (qytete, qyteza, katunde, lagje etj.); si pjesë e tyre mund të shihen edhe **etnonime** apo emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nëndarjeve administrative e shoqërore të ndryshme; **hidronime** apo emrat e ujërave (dete, lumenj, liqene, përranj etj.), **oronime** apo emrat e maleve, fushave, kodrave etj.

Rrethi i **makrotoponimeve** ka kaluar shumë përtej kufijve kombëtarë të shqiptarëve:

Ndër toponimet e vendeve **të huaja** dallojmë:

Evropa, Itali, Gjermani, Libi, Bolonjë, Firenze, Sicilia, Etiopia, Afrikë, Greqi, Maqedoni, Jugosllavi, Turqia, Spanjë, Firenze, Korfuz, Shpellën e Qikllopot, Stefingrad, Olimp, Venediku, Stamboll, Parisi, Arabistan, Vietnam, Francë, Labrador, Ballkan, Vardar, Madrid, Shtutgard, Bosfori, Egjeu, Mesdheu, Zyrihut, Parisin, Berlin, Maqedoninë, Athinë, Heraklia, Taranton, Askolin, Beneventon, Argosin, Aleksandria, Kartagjena, Roma, Parma, Libi, Evropa, Itali, Gjermani, Libi, Bolonjë, Firenze, Sicilia, Etiopia, Sicili, Venecies, Greqi, Mal të Zi, Evropi, Frëngu, Janinë, Tokio, Gjermani, Angli, Brindizi, Egjipt, Gjibraldar, Balltiku, Torino, Lindja e largme, Londër.

Toponimia e trojeve shqiptare përfshin:

etnonimet apo emrat e shteteve, kombeve, kombësive, krahinave, nëndarjeve administrative e shoqërore, kemi: *Epir, Arbëri, Aulona, Albulenë, Tumenishtë, mollose, thesprote (Eklipsi i ëndrrës), Shqipëri, Martanesh, More, Labëri, Torviolli, Vajkali, Poezi; Smokthinë, Lunxhëri, Shqipëri e Mesme, Shqipëri e Veriut, Zagori, Dikush më buzëqeshte;*

Emrat e vendbanimeve (Ojkonimet)

Emrat e vendbanimeve shqiptare sidomos ato në kodin më të vogël të parë në tërësinë e vet, na dëshmojnë për një pasuri të madhe e mbështetje të fuqishme në toporrënjë shqiptare: *Boras > borë, fshatit Rrëzë, fshatarëve të Rrëzomës > rrëzë, Rrapëz > rrap, fshatin e Vajzës > vajzë, Bardhajt > bardhë (i), në Kopaçës > kopaçe (dru të trasha të thata), fshatit Lis > lis, në Gropës > gropë, në Mollas > mollë, në Çukëz > çuk (i bëri vetullat çuk, i mblodhi), Gurëbardhë > gurë + bardhë (i), në Grenjas > gërryer, Shkurraj > shkurre Pëllumbas > pëllumb (romani Shokët);*

Me rëndësi të madhe kanë qenë e janë kudo emrat e vendbanimeve apo siç quhen me termin përkatës **ojkonimet** apo emrat e vendeve të banuara (qytete, qyteza, katunde, lagje etj.). Mjaft prej ojkonimeve shqiptare janë të lashta,

porse ato, ashtu si në çdo gjuhë në rrjedhë të shekujve kanë pësuar edhe ndryshime, disa kanë mbetur por janë ndërruar fonetikiisht Aulona-Vlona. ...në *Brataj, fshat si Smokthina, në Kaninë, Penkovë, Mavrovë, në Dukat, Borshit, kalova Mursinë, Skrapar, katundit Frashër* kurrizon e shëmtuar të *Boderrit*, për në *Kuç*, në fshatin *Tremisht*, përballë *Kalivaçit, në Dorrëz, në Sinanaj, Matohasanaj, Dhëmblan, Tepelenës*, lagjja *Muradie*, lagjes së *Çerekçisë*, Romani “**Dikush më buzëqeshte**” katundi i *Grykëpishës, Fshatarët e Kodërdehit, fshatarëve të Breglumit, në Sherishtë, në Vlorë, Lapardha, Lubonja e Penkova, Poro (Deti në mes); Brymas, Vërlen, Borasi, fshatarëve të Rrëzomës, Progonati, Rrapëz, fshatin e Vajzës, Bardhajt, Në Kopaçës, fshatit Lis, në Gropës, fshatit Rrëzë, Bodinasi, në Llazat, në Mollas, në Çukëz, Lekzi, nga Kuçi, Kallarati, Gurëbardhë, në Grenjas, nga Bronjari, Progonati (romani Shokët) Holta, “Nuk shitet shpirti në tetor”;* Zvërneci **Më vjen keq për Jagon;**

Oronimet apo emrat e **maleve, fushave, kodrave** etj.⁶: *Mali i Rrufesë, fushë të Mavrovës, në fushë të Xhyherinës, Kodrën e Vogël, Kodrës së Drizës, në grykën e Velçës, Luadhi i Verdhajve (Deti në mes); në malin e Nemërçkës, në Mal të Çipinit, në malin e Hoçit, malit të Kokojkës, Mali i Çajupit, Përmet, fusha e Shkozës, mali i Kolonjës, “Dikush më buzëqeshte” hijeve të Çikës, Llogara, Gryka e Matit, Qaf’pëllumbi, nga “Poezi” Shashicë, Karaburun, Llogoraja, Fushë – Kosovë, Sazani, Tomori, “Eklipsi i ëndrrës”;* *Mali i Rrufesë, Çuka e Vetëtimës, “Shokët”;* *malet e Vetëtimës “Duke dalë prej ëndrrës”;*

Emrat e ujërave apo hidronimet

Hidronime: *Joni, Vau i Dejës, Bistricë, Drini i Zi, Drini i Bardhë, Bunë, Poezi; Adriatiku, Vjosa, Gryka e Matit Eklipsi i ëndrrës;* *grykës së Sazanit e të Karaburunit (hunda e zezë), grykës së Selckës, gjatë luginës së Shushicës (Romani “Dikush më buzëqeshte”).* Disa prej emrave janë përmendur qysh në lashtësi e disa më të vona (më të vegjël).

Mikrohidronimet që përmbajnë fjalët shqipe **krua, burim, gjol, pus,** etj. kroi i madh, *përroi i Verdhashit, përroi i Kaçorrit* (romani **Shokët**)

Nga hidronime janë krijuar edhe jo pak ojkonime si: *Breglumë, Kodërdehit.*

- Emrat e vendeve të vogla (**mikrotoponimia**)

Njeriu ka nevojë kurdoherë për një kod tjetër, më të ngushtë, me anën e të cilit ai fikson emrat e objekteve, sendeve, dukurive më të vogla, por jo më të parëndësishme se ato të mëdhatë. Madje pikërisht ato objekte, dukuri etj. që përfshihen në arealen e kodit më të ngushtë, më të vogël kanë rëndësinë më të madhe për jetën e përditshme të njeriut prandaj edhe kanë qenë e janë aq të shumta, po edhe aq të rrënjosura në gojën e popullit. Krahas emrave të maleve

⁶Gjovalin Shkurtaç, *Onomastikë dhe linguistikë*, shblu, f. 13-43, Tiranë, 2001.

të mëdha, kudo ka edhe emra të pikave të caktuara të tyre (**qafa, gryka, shkëmbinj, udhë, rrugë, shtigje, çuka; fusha, ara, lëndina, kullota, pyje etj.**) që kanë rëndësi ekonomike të dorës së parë për banorët: *në fushë të Mavrovës. në fushë të Xhyherinës, urës së Drashovicës.ura e Gjormit, ura e Drashovicës, Kodrën e Vogël, Kodrës së Drizës, në grykën e Velçës, Lufta te Pylli i Pëllumbave (Deti në mes); Qafa e Botës, Çuka e Vetëtimës, (romani Shokët) te udha e Budakut, në udhën e Skelës, të fushën e Shkozës. shpella e Boderrit, Qafa e Bozhekut, lagjja Muardie, në Qafën e Koçiut, qafës së Dhëmbelit, udha e Tabakëve (Romani “Dikush më buzëqeshte”) rruga "Sofra e vjetër", “Nuk shitet shpirti në tetor”; Gryka e Matit (Eklipsi i ëndrrës).*

Toponimia ndonjëherë fikson ngrehina që kanë funksione të ndryshme pragmatiko-shoqërore, si **hani, pazari, teqeja** etj. të cilat me kohë, edhe mund të ndryshojnë, por emërtimi mbetet. Në veprat e studiuara, na bie në sy parapëlqimi i autorit për të sjellë emrat e vendeve të shenjta: *kishën e madhe të shën Vasilit, kisha e shën Mërisë, Shën Triadha (Deti në mes); në teqen e Turanit, në Gurin e Ylyncit, xhamia e Tabakëve (Romani “Dikush më buzëqeshte”) Shën-Triadhë, Deti në mes; në Shënepremte, “Nuk shitet shpirti në tetor; Qafa e Shëngjergjit “Duke dalë prej ëndrrës”.*

Çdo pikë e vendit ku ka pasur një gjë të shënuar, ku është bërë një betejë, ku ka ndodhur një histori, zakonisht është fiksuar në toponimi. Bashkë me emrin e vendit fiksohen edhe emrat e personazheve të ndryshëm që kanë qenë protagonistë apo, pronarë a zotërues të tyre *në Arën e Harapajve, Luadhi i Verdhajve (Deti në mes); ara e Andonit, në shtëpinë e Pëllumbajve, shpellën e Bilbilenjve, përroi i Verdhashit, përroi i Kaçorrit (romani Shokët).*

Toponimia agrare

Mollas, fshatit Lis, Kopaçës, Rrapëz, (romani Shokët) Kodrës së Drizës, katundi i Grykëpishës, (Deti në mes); Shkozën, nga shkozë –dru shkoze, katundit Frashër nga frashër, kalova Mursinë nga mursi (xina) (Romani “Dikush më buzëqeshte”)

Ndërtimi i toponimeve⁷

Lidhur me kuptimin e toponimeve të një krahine duhen ditur e mbajtur parasysh:

- Lidhjet midis toponimeve me realitetin (me natyrën e vendit, me ngjarje e rrëfime të ndryshme) *katundi i Grykëpishës, Fshatarët e Kodërdetit, fshatarëve të Breglumit, fshatit Lis, në Gropës, Mollas, Bardhajt, Çuka e Vetëtimës, Brymas, Borasi, Dhëmban, çipini, Në Kopaçës, Qafa e Botës. Vërlen, dhe nga ana tjetër lidhjet e toponimeve me fjalët e tjera të gjuhës.*

- Mënyra sesi populli i ka emërtuar viset e ndryshme, duke marrë bazë shenja ose dukuri nga më të larmet si: ngjyra, forma, përmasat, rrethanat të ndonjë ndodhie a veprimi historik a legjendar etj. kanë rëndësi të madhe jo

⁷Gjovalin Shkurtaç, *Onomastikë dhe linguistikë*, shblu, f. 54-55, Tiranë, 2001.

vetëm në planin gjuhësor, po edhe për psikologjinë sociale kombëtare të shqiptarëve sepse nëpërmjet kësaj ane ne njohim më thellë edhe mendësinë (mentalitetin) karakteristike të popullit tonë:

a. Përshkrim i mirëfilltë i vendit, duke përdorur togje të përbëra nga emër (apelati) + mbiemër që tregon cilësi: *Kodrën e Vogël*, “*Sofra e vjetër*”, *Drini i Zi*, *Drini i Bardhë*, *Karaburuni* (hunda e zezë).

b. Përshkrim mbi bazën e një togfjalëshi të përbërë nga emri që tregon veçorinë topografike + emër të rasës gjinore që tregon përkatësinë apo ndonjë rrethanë historiko – shoqërore. Ky është tipi më i përdorur në toponiminë shqiptare. *Çuka e Vetëtimës*, *Mali i Rrufesë*, *Kodrës së Drizës*, *Qafa e Pëllumbit*.

c. Përshkrim mbi bazën e metaforës ose tropeve: *Hunda e zezë* (grykës së Sazanit e të Karaburunit) *Mal të Çipinit*, ...

ç. Përshkrim me apelativin që tregon realitetin topografik + ndonjë prapashtesë ku shquajnë, sidomos:

-**ës**, -**ëz**: *Kopaçës*, *Gropës*, *Çukëz*, *Rrapëz*, *Lekëz* (romani **Shokët**);

-**aj**: *Bardhaj*, *Sinanaaj*, *Matohasanaaj*, *Brataj* (Romani “**Dikush më buzëqeshte**”) (romani **Shokët**) Arën e Harapajve, Luadhi i Verdhajve (**Deti në mes**);

-**isht**: *Tremisht*, *Repishti*. (Romani “**Dikush më buzëqeshte**”) *Tumenishti*. (**Eklipsi i ëndrrës**);

-**at**, -**an**: *Dukat*, *Dhëmblan*, *Nivan*. (Romani “**Dikush më buzëqeshte**”);

- **as**: *Brymas*, *Boras*, *Bodinas*, *Mollas*, *Grenjas* (romani **Shokët**);

Me kompozitë kemi: katundi i *Grykëpishës*, Fshatarët e *Kodërdehit*, fshatarëve të *Breglumit*, (**Deti në mes**); *Gurëbardhë*, *Fushbardhë* (romani **Shokët**) Flisje lart në *Fushëlugje* **Duke dalë prej ëndrrës**; *Matohasanaaj* “**Dikush më buzëqeshte**”; fshatit *Skuterrë*, fshatin *Trepullazë*, në *Shënepremte*, “**Nuk shitet shpirti në tetor**”.

Mikrotoponimia e trojeve shqiptare, e parë në tërësinë e saj na jep një pasqyrë të historisë ekonomiko – shoqërore të secilit vis përkatës.

Veprat me më shumë fjalë onomastike janë: romani “**Shokët**” dhe tri novelat botuar në titullin “**Nuk shitet shpirti në tetor**”. Këto vepra dallohen jo vetëm për numrin e madh të fjalëve, por edhe për dendurinë e përdorimit të tyre, e sidomos spikat disa emra, të cilët kanë interes si në ndërtimin dhe kuptimin që sjellin, ashtu edhe në mishërimin e ideve të autorit.

Në romanin “**Shokët**” gjenden **158 fjalë onomastike**.

Vendin kryesor ndër to e zënë ato të origjinës **shqipe**, si: 330 Azem, 129 Labike, 117 Bardhyli, 73 Agimi, 72 Bato, 33 Luanit, 6 Rrufeja, 4 Leloja, 4 *Refiku*, 3 Leka, 2 Kume, 1 Vojoja, 1 Prënjo, 1 Iliri, 1 Kilja, 1 Lame, 1 Larës “**Shokët**”. Ndër antroponimet shqipe një nëngrup përbëjnë emrat familjarë (**eponimet**): 1 Gjonmadhi, 1 Shkurraj, 203 Bunga, 65 Duka, 22 Çermën, 9

Bardhaj, 11 Mio Balli, 4 Pëllumbajve, Zeqoja, “**Shokët**”. Jo të pakta janë edhe antroponimet me origjinë **turke e arabe**: 1 Abaz, 10 Aliu, 16 Esma, 8 Evrenoz, 3 Fadilit, 4 Fiço, 1 Hatixheja, 3 Hyso, 6 Muharrem, 2 Zeqoja, 3 Myrtoja, 24 Xhavit, 1 Xhezoja, 1 Qemali, 1 Shyqyriun, 35 Skënderi, 1 Bajram, 20 Nesho, 5 Fatoja, 2 Halo, 2 Mevlud, 112 Gjike “**Shokët**”; Gjithashtu një vend të rëndësishëm zënë **antroponimet greke**, 3 Sokrati, 1 Andonit, Lefterin, 4 Mërkur, Filipi “**Shokët**”; Antroponimet **latine** ndeshen kryesisht figura historike: 13 Mikele, 3 Musolini, 32 Vita, 1 Viktor “**Shokët**”; **Antroponimet angleze e gjermane** 1 adolfi.

Toponimia:

etnonime: 1 Evropë, 2 Afrikë, 2 Greqi, 1 Maqedonisë, 3 Italia, Jugosllavi, 1 Turqia, 1 Spanjë, 3 Firence, 3 Korfuz, Shpellën e Qiklopit “**Shokët**”.

Toponimia e trojeve shqiptare përfshin: 27 Shqipëri, 4 Vlorë, 4 Delvinë, 2 Kruja, 1 Gjirokastrë, *fshatit 6 Rrëzë*, Rrëzoma, 3 Mollas. 28 Brymasi, 7 Gurëbardhë, 2 Lekzi, 8 Borasi, 1 Bërrylas, 1 Kallarati, 2 Rrapëz, 4 Bodinas, Mali i Rrufesë, Çuka e Vetëtimës, përroi i Verdhashit, Qafa e Botës.

Mund të themi se fjalët onomastike zënë rreth 23.7% të fondit të përgjithshëm leksikor në këtë vepër.

Në vepërën “**Nuk shitet shpirti në tetor**” kemi rreth 62

26 Afërdita, 28 Bora, 44 Bruka, 40 Bubesi, 4 Bukëmira, 35 Faraon, 1 Skënderbeu, 52 Fatos, 11 Hiçi, 6 Hiçkëla, 9 Gentianën, 35 Greth, 4 Ilir, 8 Guralumi, 21 Besnik, 20 Bisha, 19 Engjëll, 20 Cukalla, 27 Drit, 21 Bardha, 14 Kuca, 7 Sazan, 10 Ulku, 1 Agim, 1 Buxhuku, 11 Zamiri, 41 Ago, 39 Arëza, 15 Velo, 19 Shtërgu, 19 Tokaj, 23 Korab, 22 Gruda, 18 Mira, 21 Vogli, 21 Putana, 94 Madh, 23 Kopili, 3 Miroshi, 9 Vezir, 9 Alushi, 50 Redon, 1 homeri, 4 Suzana, 31 Nik, 32 Niku,

35 Greth, 11 Zamiri, 18 Mira, 20 Vogli, 19 Putana, 16 kopili, 7 Kopilin, 6 Hiçkëla, 10 Shega, 9 Vezir, 10 Alushi, arapi,

10 Shqipëri, 1 Vlorë, 36 Tirana, 30 Holta, 6 Trepullaze, 1 Sofje, 2 irlandeze, 2 osmane, 4 Skuterrë, 2 rrugës së Dibrës, rruga “*Sofra e vjetër*”, 8 hotel Dajti, 2 Shënepremte,

Në novelën “**Nuk shitet shpirti në tetor**” kemi gjithsej 58 antroponime dhe 11 toponime.

26 Afërdita, 28 Bora, 44 Bruka, 40 Bubesi, 4 Bukëmira, 35 Faraon, 1 Skënderbeu, 11 Hiçi, 6 Hiçkëla, 9 Gentianën, 35 Greth, 4 Ilir, 8 Guralumi, 21 Besnik, 20 Bisha, 19 Engjëll, 20 Cukalla, 27 Drit, 21 Bardha, 14 Kuça, 7 Sazan, 10 Ulku, 1 Agim, 1 Buxhuku, 11 Zamiri, 41 Ago, 39 Arëza, 15 Velo, 19 Shtërgu, 19 Tokaj, 23 Korab, 22 Gruda, 18 Mira, 21 Vogli, 21 Putana, 94 Madh, 23 Kopili, 3 Miroshi, 9 Vezir, 50 Redon, 1 Homeri, 4 Suzana, 31 Nik, 32 Niku, 35 Greth, 11 Zamiri, 18 Mira, 20 Vogli, 19 Putana, 23 Kopili, 6 Hiçkëla, 10 Shega, 9 Vezir, 19 Alushi,

10 Shqipëri, 1 Vlorë, 36 Tirana, 30 Holta, 6 Trepullaze, 1 Sofje, 2 irlandeze, 2 osmane, 4 Skuterrë, 2 rrugës së Dibrës, rruga “Sofra e vjetër”, 8 hotel Dajti, 2 Shënepremte.

Nga një vëzhgim i thjeshtë vërejmë një tjetër pamje të përdorimit të onomastikës. 90 % e antroponimeve janë të origjinës shqip dhe vetëm 10 % me origjinë të huaj. Por ajo që duam të theksojmë më tepër është kujdesi që autori tregon për cilësinë e tyre. Duket se përveç kujdesit të madh për gjuhën e tekstit në përgjithësi një kujdes i veçantë i tij është edhe për antroponimet. Atë janë fjalë të fondit të vjetër shqip si: *Ilir, Drit, Besnik, Afërditë, Korab, Mira, Agim, Bora, Bardha* etj., edhe antroponime dhe patronime të krijuara me brumin e shqipes si: *Bukëmira, Hiçkëla, Miroshi, Tokaj*, etj. E shkruar relativisht vonë (viti 2000), pas një përvoje të gjatë autoriale dhe sipas meje me kërkesa shumë të larta tek vetja e bëjnë këtë vepër shumë të suksesshme edhe për shkak të një onomastike brilante.

Nga shqyrtimi i antroponimisë shqipe vërehet se prej 58 rasteve, që dalin gjithsej, një pjesë e mirë janë krijime të tij, mbështetur në gjedhet fjalëformuese si dhe në veçoritë psikolinguistike të krijimit të antroponimeve në gjuhën shqipe.

Emrat e personazheve⁸

Çdo epokë historike, edhe pse gjuha nuk bën pjesë në strukturë dhe është dukuri shoqërore e veçantë, lë gjurmët e veta edhe në gjuhë sidomos në leksik dhe në emrat e njerëzve. Kështu. Rilindasit tanë të mëdhenj duke e kuptuar se pushtuesit e huaj me anën e fesë po i përdornin edhe emrat e njerëzve si nxitje për dallim, për çarje e copëtim krahinor e shoqëror të shqiptarëve. Nuk ishte e rastit që edhe në fillesat e letërsisë artistike të asaj periudhe tregimi “Gjahu i Malësorëve” i K. Kristoforidhit na jep emra personazhesh të tillë si: Arbër, Toskë, Gegë, Gjergj, Mërkur, Mark Shalgjati etj., të cilët, përveç simbolikës përbashkuese kishin një vlerë modelore si emra njerëzish (antroponime) të brumit anëtar ose të shqiptarizuar në mënyrë të ndjeshme. Naim Frashëri e rilindës të tjerë kanë bërë një punë të madhe me gjuhën në shumë drejtime. Ata vunë gurët e parë të antroponimisë artistike dhe mëtuat t’i prinin sëmbari punës në këtë lëndë. Këtu, do të përmendim ndër të tjera emrin e Kamanit të “Historia e Skënderbeut”. Një personazh aq simpatik, por edhe një emër të bukur e me një jehonë të përshtatshme për të gjitha trevat shqiptare. Në të njëjtën hulli ecën edhe shkrimtarët arbëreshë, F. A. Santori, personazhin kryesor të dramës së parë të letërsisë shqipe, do ta quante e mira, ndërsa De Rada tek “Milosao”, krahas Milosaut, na jep edhe emrin e bukur Rina. Kjo hulli e mbarë do të vazhdonte për shumë mote në letërsinë shqiptare të Rilindjes. Kujtojmë A. Z. Çajupi me dhe Lulushen, Ndre Mjeda me Zoga,

⁸Gjovalin Shkurtaç, *Onomastikë dhe linguistikë*, shblu, f. 177, Tiranë, 2001.

Tringa dhe Loken e cila u bë personazh edhe i dramave të vona “Toka jonë” e K. Jakovës, dhe “Cuca e maleve” e L. Papës. Letërsisë artistike i bie barra që, nëpërmjet emrave të personazheve të japë edhe gjedhen (modelin) sesi duhen vënë emrat e njerëzve. Antroponimia artistike apo emrat e personazheve, të dramave, romaneve, novelave, tregimeve etj. përbëjnë një gurrë të pasur e ndikuese për antroponiminë shqiptare.

Edhe Fatos Arapi tregon kujdes të veçantë për emrat e personazheve. Ai ka sjellë një galeri personazhesh thelbi i të cilëve është mishëruar metaforikisht edhe në vetë emrat e tyre. Kjo lidhet ngushtë me qëndrimin ideoemocional të autorit dhe bëjnë efekte të ndjeshme në veprat letrare.

Karakterizimit dhe tipizimit të personazheve autori u ka kushtuar një vëmendje të veçantë. Autori kujdeset për personazhet e tij për t’i dhënë ata në shumë plane, si në planin psikologjik, temperamentin, botën e brendshme, karakterin, ashtu edhe në përshkrimin e cilësive fizike. Emrat e personazheve të F. Arapit janë kryesisht me kuptim domethënës. Tek personazhet autori me anë të shënjesit gjuhësor-emrit, duket sikur ka skalitur një pjesë të karakterit të tyre. Këtë autori e realizon me emrat, mbiemrat dhe emërvendet ku lëvizin personazheve, por kryesisht me anë të mbiemrit.

Le ta ilustrojmë idenë e mësipërme me disa pjesë ku përshkruhen personazhet tanë. Fiqo Hajduti. Qysh në takimin e parë me këtë personazh mendojmë se është mbartës i një vesi të keq, atë të hajdutërisë. Autori me mjeshtëri, jo vetëm që na e përforcon idenë, por shkon shumë më larg se imagjinata e lexuesit. “*Dhe mendoja se ato duar mund të ishin fare mirë të Fiqo Hajdutit nga Progonati, që nuk la gjë pa vjedhur. Thonë se Fiqo Hajduti e therte dhe e rripte cjamin duke ecur*”.

Kritikja Bardha Kuça: presim të kemi një personazh që të tjerët duhet të tremben prej saj, duhet të jetë një personazh që nuk rri rehat. Kjo është realizuar edhe nëpërmjet profesionit të saj si kritike letrare, duhet të mbaj qëndrim, të flasë shumë, të shkruaj shumë, “të leh si kuç (qen i vogël), për të shprehur idetë e saj, (në një mjedis ujqërish), apo “llapaqene”, siç thotë Sazan Ulku, një ujk i vjetër të cilit është vështirë t’i dalësh përpara. Por ashtu si dhe ujku që ka frikë nga shkopi, Ulku ynë ka frikë nga gishti i së shoqes kur drejtohet lart. Ja disa ilustrime për këto dy personazhe: *as shkrimin e kritikës Bardha Kuça nuk e pëlqeu aspak pedagogu i Filologjikut, studiuesi e kritiku i shumënjohur Sazan Ulku. Në katedër, tek po c lecitnin në një lexim gati kolektiv, me gazetën në dorë, Ulku thirti: - Kjo është vetëm një llapaqene dhe pena e saj do të bëjë hatanë.*

Ata që e njihnin shpirtin hakmarrës të Ulkut, i druhashin dhe i largoheshin atij.

Një tjetër personazh ku mbiemri përshtatet jashtëzakonisht shumë me karakterin është Besnik Bisha: pret në heshtje duke përgjuar, sikur ka dalë të gjuaj, ka kyçe të fuqishme, shpatulla të zgjeruara e të përkulura, kurriz të

lakuar, duket se ke përpara një bishë të frikshme edhe pse e veshur me këmishë të kaltër. Ideja përforcohet nga duart përherë të lidhura që instruktori i mbante gjithnjë midis gjunjëve. Nuk ka si të jetë tjetër është instruktur, duhet të ngjall frikë te vartësit: *instruktori i shtypit Besnik Bisha, u ndal në mesin e zyrës. Priti në heshtje duke përgjuar me shikimin e tij mbi tryezën e punës së shefit gazetën "Bujku", krahun e hijshëm, kyçin e fuqishëm të dorës, orën "Pobieda", mëngën e këmishës së kaltër me vijëza. Bisha erdhi e u ul aty. Greth Bubesi e detyroi veten dhe e pa instrukturin drejt e në sy, pastaj ai mbloodhi me shikimin e vet ato shpatulla të zgjeruara e të përkulura para që i jepnin kurrizit një lakim të ndjeshëm, the dy duart përherë të lidhura instruktori i mbante midis gjunjve.*

Për Ilir Guralumin më shumë se emri dhe mbiemri që mbështeten në tabanin popullor shqiptar, flet prejardhja e tij, fshati Skuterrë, që askush nuk e di ku bie kjo skutë e errët, dashka të flasë e të mbrojë një njeri si Bardha Kuça, ai nuk mund të kundërshtojë të mëdhenjtë, sepse vjen nga një vend i vogël, ai s'është gjë tjetër veçse një viç i palëpirë, sepse me viça ndoshta është rritur: *Të dhënat thoshin se Ilir Guralumi ishte prej fshatit Skuterrë. Ilir Guralumi kishte shkruar për atë novelë..., - E, mo, ku merr vesh ai viç i palëpirë nga kritika... unë e lexova, phuuu...*

Një personazh interesant dhe mjaft domethënës është edhe nëna e dy djemve partizanë të vrarë, me emrin Labike. Ajo gëzon tiparet e nënave labe. Është e dashur me fëmijët (njërin e kanë të përkëdhelur), vajon me ligjet e Labërisë djemtë e vrarë, është e fortë e guximshme, burrërore për të duruar dhimbje të tilla, por mbetet grua që përkujdeset për të shoqin edhe në momentet më të vështira:

- Agimi ishte imi, - i tha përsëri gruaja. *Eh, more i përkëdheluri i Labikes... U dëgjua një ulërimë që shpoi qiellin e tokën. Të dy burrat u panë në sy. Asnjëri prej tyre nuk dëshironte ta dëgjonte atë zë. Labikja, - tha Azemi. Vetëm kur dëgjonte vajin e Labikes ai afrohej atje. ... Mirë se erdhe... Oh, ti qenke, djalo? Të keqen nëna, po si dole këtu? Megjithëse moti nuk ishte ftohur, si gjithnjë Labikja e kishte ndezur zjarrin në vatër. ... Mbahu, moj nënë e Batos!*

Skënderi e shtrëngoi atë fort në kraharor.

- *Ti je burrneshë! Labikja mori ndër duar kokën e Skënderit, u ngrit në majë të këmbëve dhe e puthi atë në ballë.*

- *Si të thoni ju..., - tha ajo me një fije zëri. - Si të thoni ju, djem...*

Plumbat i hanë burrat, po na vrasin edhe ne gratë, - tha Labikja.

Afërdita Tokaj, e lidhur fort me këtë tokë, me kërkesa drejt së resë drejt përparimit. Ashtu shtatlartë, e mërziur dhe e dëshpëruar, përsëriste hidhshëm: *O Zot! ç'fat i mjerë ky i popullit tonë. Kur do të bëhemi edhe ne një herë njerëz, me të vërtetë njerëz. Kur do të ecim edhe ne një herë me botën?*

Mira Vogli e vogël në shtat e vogël edhe në moral, e vogël edhe në kërkesa: *E shkurtër, e imët, ajo kishte një fytyrë të murgët dhe një shtat*

përherë në lëvizje. ... Nuk zbërthehet kurva, - kishte thënë Afërdita Tokaj. - Ne jemi mësuar me banjat turke, - pëshpëriti redaktorja e tretë, Mira Vogli, - kush ia nis tani nga e para edhe me nevojtoret? ... Ti, Mira Vogli, nuk e ke fare ndjenjën e përparimit.

Ago Arëza është një tjetër personazh që të mbetet gjatë në mendje, para të cilit je i dyzuar nëse është ara pjellore, e të mirat e saj apo arëza (arrëz), insekti thumbues, që nuk lë vend pa hedhur helm: *Ago Arëza vendas nga Holta. - Po përshkruante fshatin kur e ndërpreu bisedën, u çua në këmbë dhe tha: - Ja përse ta presin hundën në Holtë... Ishte Ago Arëza, ai me ate shikimin e tij të ftohtë e përgjues, me ato mustaqe si një akrep i hirtë. Një krijesë e stërrallte e këtyre anëve. Shikimi i tij ishte i ftohtë dhe i pingultë, këtij njeriu s'mund t'i besojë, duhej kujdes kur i afroheshe kësaj qenieje. Holta e kishte marrë vesh se unë, i huaji, kisha ardhur mbrëmë në fshat. Ago Arëza e kishte bërë detyrën e vet. (arëza e kishte shpërndarë lajmin)*

Hiçi i Madh: *"Shkel mbi të tjerët dhe ec përpara! Shkel mbi të tjerët!" Klubi shpërtheu në brohoritje drithëse. Njeriu që do të bëhej Hiçi i Madh thoshte: - Mjerë ai popull që dëgjon demagogët e vegjël, shpirti i madh i këtyre kohëve të reja që jetojmë na urdhëron të shkelim mbi të tjerët e të ecim përpara!*

Përdorimi i personazheve negativë apo pozitivë me kuptime metaforike lidhet ngushtë me qëndrimin ideoemocional të autorit dhe bëjnë efekte të ndjeshme në veprat letrare.

Autori tregon kujdes në onomastikën letrare. Ai përzgjedh fjalë të fondit të vjetër të shqipes si: dritë, gur, borë, mirë, bardhë (i), dhe i përdor si rrënjë për antroponimet dhe toponimet si ato me burim popullor ashtu edhe të krijuara nga ai vetë. *Bardha Kuca, Bardhaj, Gurëbardhë, Drit Bora, Boras, Met Guri, Ilir Guralumit, Gurëbardhë, Mira Vogli, Zamir Milori, Suzana Miroshi*, kritiku *Bukëmira*, Mbiemrat janë përdorur me kuptime metaforike. Kjo lidhet ngushtë me qëndrimin ideoemocional të autorit dhe bëjnë efekte të ndjeshme në veprat letrare.

Patronimet ndërtuar në pjesën më të madhe të tyre nga emra të përgjithshëm, në vijim të traditës dhe kryesisht nga emra të fondit të vjetër të gjuhës shqipe: Gjena e *Bletajve*, Dane *Pëllumbi*, Alem *Bejkos*, Hysen *Kaleshi*, Met *Guri*, Kristo *Driza*, Niko *Gropa*, Drit *Bora*, Sazan *Ulku*, Afërditë *Tokaj*, Besnik *Bisha*.

Edhe patronimet që bien lehtë në sy të ndërtuara prej tij kanë në përbërjen e tyre fjalë shqip: Suzana *Miroshi*, Ago *Arëza*, Ilir *Guralumit*. Emra të përveçëm që të mbeten gjatë në mendje janë: zonja *Hiçkëla*, *Hiçi i Madh*, kritiku letrar *Bukëmira*...etj.

Interes shfaqin edhe toponimet të ndërtuara sipas modeleve të njohura kemi ndërtimet: *Gurëbardhë, Fushëlugje, Breglumë, Kodërdet, Grykëpishës nga gjedhi: Fushbardhë.*

Onomastika në krijimtarinë e Fatos Arapit

Në këtë vepër të F. Arapit dalin më shumë se 700 njësi onomastike (rreth 450 antroponime dhe më shumë se 250 toponime), të përdorura si në poezi ashtu edhe në prozë. Edhe pse kërkon të bëjë një shpërndarje të drejtë proza duket se i jep më tepër dorë në përdorim. Nga veprat në prozë me përdorim më të dendur të njësive onomastike janë “Poezi” dhe “Eklipsi i ëndrrës”, nga veprat në prozë romani “Shokët”.

Nga shqyrtimi i antroponimisë shqipe vërehet se prej 700 njësive që dalin gjithsej, një pjesë e mirë janë krijime të autorit, mbështetur në gjedhet fjalëformuese si dhe në veçoritë psikolinguistike të krijimit të antroponimeve në gjuhën shqipe.

